



Miratimi i Udhëzimeve të reja për Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve në lëndët civile


Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it, me rastin e Asamblesë së trembëdhjetë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Prishtinë më 27 janar 2011, e përbërë nga këta Gjyqtarë:

Maria Giuliana Civinini, Charles Smith, Martti Harsia, Lars Dahlstedt, Gerrit-Marc Sprenger, Tapio Vanamo, Torsten Koschinka, Norbert Koster, Piero Leanza, Anna Bednarek, Esmä Erterzi, Antoinette Lepeltier-Durel, Laura Plesa, Roxana Comsa, Katerina Entcheva, Francesco Florit, Arkadiusz Sedek, Ferdinando Buatier de Mongeot, Karen Asphaug-Warg, Gianfranco Gallo, Horst Proetel, Johanna Schokkenbroek, Verginiya Micheva-Ruseva, Dragomir Yordanov, Vitor Hugo Pardal, Rositza Buzova, Gunnar Oyhaugen, Franciska Fiser, Riku Jaakkola, Witold Jakimko, Vladimir Kanev, Klaus Jung, Hajnalka Karpati, Nikolay Entchev, Caroline Charpentier, Christine Lindemann-Proetel, Jonathan Welford-Carroll

me 28 vota për, 1 kundër, 6 abstenime dhe 2 gjyqtarë nuk shprehën votën e tyre,

VENDOS

Të vërtetojë Udhëzimet e reja për Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve të EULEX-it në lëndët civile.


Maria Giuliana Civinini
Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

ANEKS: Udhëzimet e reja për Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve të EULEX-it në lëndët civile.

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë
Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu



Udhëzime për Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve të EULEX-it në Lëndët Civile

Baza Ligjore

Caktimi i lëndëve i Gjyqtarëve të EULEX-it do të bëhet në përputhje me Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-053), Ligji mbi Kompetencat. Këto udhëzime do të shtjellojnë përshkrimet mbi caktimin e lëndëve të caktuara me ligjin e lartpërmendur.

Parimet

- **Transparenca**
Caktimi i lëndëve duhet të jetë transparent për akterët dhe jo-akterët në sistemin e drejtësisë.
- **Objektiviteti**
Të gjithë duhet ta dinë paraprakisht nga cili gjyqtarë ai/ajo do të gjykohej.
- **Fleksibiliteti**
Kushtet specifike të punës, dhe numri i gjyqtarëve të EULEX-it duhet të merren parasysh.
- **Qëndrueshmëria**
Sistemi për caktimin e lëndëve duhet të jetë shembull i zbatimit të duhur të drejtësisë të cilin gjyqtarët vendor mund (duhet) ta ndjekin në mënyrë që t'i arrijnë qëllimet e një administrimi të pavarur, transparent dhe efikas të drejtësisë.
- **Ndarja e barabartë e punës së gjyqtarëve**

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rruga Luan Haradinaj
Avenyja e Policisë
Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu



Sistemi i përzgjedhjes dhe i caktimit të lëndëve

1. Neni 5.1 a): Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

1.1.: Në pajtim me Nenin 5.1 a) të Ligjit mbi Kompetencat Gjyqarët e EULEX-it do të kenë kompetencë që të përzgjedhin dhe marrin përgjegjësi mbi lëndët që janë në kompetencë të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, përfshirë këtu lëndët që i janë referuar ndonjë gjykatë tjetër në pajtim me ligjin në fuqi; Kompetenca e Odës së Veçantë së Gjykatës Supreme lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit qeveriset nga Ligji mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe nga ligji tjetër në fuqi, aktualisht Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13 e ndryshuar me rregulloret e UNMIK-ut 2008/4 dhe 2008/19.

1.2.: Ku Gjyqtarët e EULEX-it janë vendosur në kolegjet e odës së Veçantë, caktimi i lëndëve do të bëhet në pajtim me rregullat e brendshme të Odës së Veçantë, bazuar në kriteret objektive të paracaktuara dhe në kujdesin procedural. Rregullat e tilla të brendshme do të përpilohen veçmas, duke marrë parasysh strukturën specifike të Odës së Veçantë.

2. Neni 5.1 b): Ankesat mbi vendimet e Komisionit Kosovar për Kërkesa Pronësore

2.1.: Në pajtim me Nenin 5.1 b) të Ligjit mbi Kompetencat Gjyqarët e EULEX-it do të kenë kompetencë që të përzgjedhin dhe marrin përgjegjësi mbi lëndët që janë në kompetencë të cilësdo gjykatë të Kosovës lidhur me ankesat kundër vendimeve të Komisionit Kosovar për Kërkesa Pronësore në pajtim me ligjin në fuqi. Kompetenca e kolegjit për ankesa të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme udhëhiqet me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50.

2.2.: Ku Gjyqtarët e EULEX-it janë vendosur në kolegjin ku ka kompetencë mbi ankesat kundër vendimeve të Komisionit Kosovar për Kërkesa Pronësore, nuk ka nevojë për qartësime të mëtejme në përzgjedhjen e lëndëve. Caktimi i lëndëve do të bëhet në pajtim me rregullat e brendshme, bazuar në kriteret objektive të paracaktuara dhe në kujdesin procedural. Rregullat e tilla të brendshme do të përpilohen veçmas, duke marrë parasysh strukturën specifike të Kolegjit për Ankesa.

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rruga Luan Haradinaj
Avenjya e Policisë
Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu



3. Neni 5.1 c): Gjykatat Komunale, Gjykatat e Qarkut dhe Gjykata Supreme

3.1.: Në pajtim me Nenin 5.1 c) të Ligjit mbi Kompetencat Gjyqtarët e EULEX-it do të kenë kompetencë që të përzgjedhin dhe marrin përgjegjësi mbi lëndët e reja dhe të pazgjidhura pronësore, përfshirë edhe procedurat ekzekutive që bien nën juridiksion të secilës gjykatë në Kosovë nëse përmbushen kushtet e përmendura në Nenin 5.1 c) (i), (ii) dhe (iii).

Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka kompetencë të përzgjedh lëndën e re apo të pazgjidhur siç thuhet në Nenin 5.1 c) të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Autoriteti përzgjedhës i një gjyqtari civil kufizohet me vlerësimin ligjor i cili i dorëzohet Kryetarit/es së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it. Vetëm në rastet kur 1) lënda nuk është pronësore në kuptim të Nenit 5.1 c) të LmK ose kur 2) qartazi nuk ekziston dyshim i bazuar në kuptim të Nenit 5.1 c), (i) to (iii), gjyqtari i EULEX-it ka të drejtë të marr vendimin e prerë. Në këto raste dispozitat e nenit 5.7 nuk ka nevojë të zbatohen.

Termi “lëndët civile që kanë të bëjnë me pronën” do të kuptohen ashtu siç është miratuar nga Asambleja e nëntë e Gjyqtarëve të EULEX-it.

- 3.2.:** Në rast se ka më shumë se një Gjyqtar Civil të EULEX-it për ekip të Gjyqtarëve të EULEX-it, Gjyqtarët e EULEX-it me radhë do t'i përzgjedhin lëndët.
- 3.3.:** Me qëllim të rregullimit të përzgjedhjes së lëndëve të reja, Shkrimorja e secilës Gjykatë të Qarkut do t'i njoftojë Gjyqtarët Civilë të EULEX-it të Gjykatës përkatëse të Qarkut për secilën lëndë që ka të bëjë me pronën.
- 3.4.:** Nëse ka baza për përzgjedhjen e një lënde, Gjyqtari Civil përzgjedhës do të njoftojë menjëherë Kryetarin e gjykatës kompetente dhe KAE mbi vlerësimin e tij/saj ligjor. Ky vlerësim duhet të jetë i bazuar, duke marrë parasysh kushtet e përcaktuara me Nenin 5.1 c).
- 3.5.:** Lista vijuese (a deri h) përmban shembuj të lëndëve që kanë të bëjnë me pronën të cilat bien në sferën e Nenit 5.1 c) dhe mund, por jo patjetër, të përzgjidhen nga Gjyqtarët e EULEX-it.
- a) Lëndët për kompensim kundër UNMIK-ut, KFOR-it, Komunave dhe personave privatë si rrjedhojë se ngjarjeve të vitit 1999 dhe 2004, të cilat janë pezulluar nga UNMIK-u;

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë
Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu



- b) Lëndët e dërguara në gjykatat kompetente vendore nga Komisioni për Kërkesa Banesore Pronësore (KKBP);
- c) Lëndët e dërguara në gjykatat kompetente vendore nga Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës (KKPK);
- d) Lëndët për pronën e patundshme private përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale që bien brenda juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të cilat gabimisht janë dorëzuar në gjykatat vendore;
- e) Lëndët për patundshmëri private përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale të cilat do të jenë në mandatin e Agjencisë Kosovare të Pronës, dhe të cilat janë dorëzuar në gjykata vendore pas skadimit të afatit për parashtrimin e padisë (3 dhjetor 2007) të zbatueshme për Agjencinë Kosovare të Pronës;
- f) Lëndët e deleguara në gjykatat vendore nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në përputhje me nenin 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4;
- g) Lëndët e ekzekutimit Civil lidhur me lëndët që bien në njërin nga kategoritë e përmendura më lart;
- h) Lëndët e tjera të ngjashme civile që kanë të bëjnë me pronën.

3.6.: Përbushja e kushteve të përcaktuara në Nenin 5.1 c) (i), (ii) dhe (iii) që rezulton me përzgjedhjen e një lënde mund të bëhet pa bindjen paraprake të gjyqtarit dhe/ose pa kërkesën e palës bazuar në Nenin 71 të Kodit të Procedurës Civile (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 4/77 me ndryshime të mëvonshme) ose në Nenet 67 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (Gazeta Zyrtare e republikës së Kosovës, Viti III, Nr 38) ose në ndonjë kërkesë tjetër.

3.7.: Në pajtim me Nenin 5.7 të Ligjit mbi Kompetencat gjyqtari vendor i caktuar në lëndën përkatëse, kryetari i gjykatës kompetente dhe palët në procedurë do ta kenë të drejtën të dëgjohen nga Kryetari/ja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it. E drejta për tu dëgjuar sipas Nenit 5.7 të LmK kërkon dëgjim verbal; për arsye të bazuara Kryetari/ja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it mund të vendosë nëse është e mjaftueshme ti jepet mundësia gjyqtarit vendor, Kryetarit të gjykatës kompetente apo palës në procedurë të japin dëshmi me shkrim.

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rruga Luan Haradinaj
Avenyja e Policisë
Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu



- 3.8.: Kryetari/ja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it mund të delegojë përgjegjësinë e tij/saj gjyqtarit civil apo penal të EULEX-it, siç është cekur në paragrafin 5.7. të LmK-së.
- 3.9.: Pas dëgjimit Kryetari/ja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it apo gjyqtari i emëruar i EULEX-it do të sjell një vendim të bazuar mbi kundërshtimin e palës apo palëve. Ankesa kundër këtij vendimi nuk është i mundur. Vendimi i bazuar nuk lidhet vetëm me caktimin e një Gjyqtari të EULEX-it në kolegji të përzier por lidhet edhe me kushtet e vëna në Nenin 5.1 c), (i) deri (iii) të LmK-së.”

4. Përbërja e kolegjeve dhe caktimi

- 4.1.: Në pajtim me Nenin 5.2 të Ligjit mbi Kompetencat kolegjet do të përbëhen nga tre gjyqtarë përveç nëse kërkohet ndryshe me anë të ligjit të procedurës në fuqi. Dy anëtarë të kolegjit do të jenë gjyqtarë të EULEX-it po që se merret vendim tjetër nga Kryetari/ja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it në përputhje me Nenin 5.5 të LmK-së. Gjyqtari i cili përzgjedhi lëndën nuk do të jetë pjesëtar i kolegjit në gjykimin e kësaj lënde. Në lëndët kur, në përputhje me ligjin e procedurës në fuqi, vetëm një gjyqtar gjykon lëndën, gjyqtari që e ka bërë përzgjedhjen e lëndës nuk do ta gjykojë lëndën.
- 4.2.: Lëndët e përzgjedhura do tu caktohen gjyqtarëve sipas sistemit numerik, me ç'rast çdo e treta lëndë do t'i caktohet gjyqtarit A, çdo e treta lëndë gjyqtarit B dhe çdo e treta lëndë gjyqtarit C (numri 1 gjyqtarit A, numri 2 gjyqtarit B, numri 3 gjyqtarit C, numri 4 gjyqtarit A e kështu me radhë).
- 4.3.: Gjyqtarit të cilit i është caktuar lënda është përgjegjës për përgatitjen e lëndës si dhe për përpilimin e aktgjykimit dhe vendimeve tjera lidhur me lëndën.
- 4.4.: Vendimi kornizë i Kryetarit/es së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it do të veçojë automatizmat e zëvendësimeve siç vijon:
- Gjyqtarët në GJQ në **Pejë** do të caktohen në GJQ në **Prizren** dhe **anasjelltas**.
 - Gjyqtarët në GJQ në **Prishtinë** do të caktohen në GJQ në **Gjilan** dhe **Mitrovicë/Mitrovica** dhe **anasjelltas**.
- 4.5.: Sistemi i kujdestarisë do të krijohet për situata emergjente për gjykatat e përmendura më lart në mënyrë që të ketë gjyqtarë në dispozicion në situata emergjente.

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë
Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu



4.6.: Në rast të ndonjë sëmundje apo situatë tjetër të papritur zëvendësuesi do të caktohet nga sektori tjetër i gjykatës përkatëse apo nëse është e nevojshme do të aplikohet sistemi i përshkruar në Nenin 4.4.

5. Të tjera

5.1.: Elementi monitorues i gjyqtarëve të EULEX-it zbatohet sipas udhëzimeve të veçanta të themeluara nga Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it.

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rruga Luan Haradinaj
Avenya e Policisë
Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu